

V E N D I M
Nr.622, datë 31.12.1993

PËR DHËNIEN E NDIHMËS EKONOMIKE

Në zbatim të ligjit nr.7710, datë 18.5.1993 "Për ndihmën dhe përkujdesjen shoqërore", ndryshuar me ligjin nr.7785, datë 27.1.1994, me propozimin e Ministrisë së Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Të ardhurat e familjes me 1 ose 2 persona që përfitojnë pagesë papunësie, përfshijnë:
 - të ardhurat nga papunësia të 1 ose 2 personave;
 - kompensimet për persona në ngarkim nga rritja e çmimeve të disa artikujve ushqimorë, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992;
 - kompensimet për persona në ngarkim, si efekt i rritjes së çmimit të bukës sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr.274, datë 12.6.1993.

2. Ndihma ekonomike mujore e plotë për familjet në qytet e në fshat është jo më e vogël se 70 për qind dhe jo më e madhe se 100 për qind të të ardhurave të familjes me 1 ose 2 persona që përfitojnë pagesë papunësie sipas përcaktimit të pikës 1, dhe llogaritet në varësi nga numri i anëtarëve të familjes si vijon:

Familja me	1 anëtar	70 për qind e të ardhurave të familjes me 1 person që përfiton pagesë papunësie
Familja me	2 anëtarë	70 për qind e të ardhurave të familjes me 2 persona që përfitojnë pagesë papunësie
Familja me	3 anëtarë	deri 78 për qind e të ardhurave të familjes me 2 persona që përfitojnë pagesë papunësie
"	4 "	deri 88 " " "
"	5 "	deri 91 " " "
"	6 "	deri 94 " " "
"	7 "	deri 98 " " "
Familje me mbi 7 anëtarë	deri 100	" " "

3. Ndihma ekonomike mujore e pjesshme për familjen me të ardhura të pamjaftueshme llogaritet si diferencë e ndihmës ekonomike mujore të plotë që përcaktohet në pikën 2 të këtij vendimi dhe të ardhurave aktuale të familjes. Kjo ndihmë nuk përfitohet nëse është më e vogël se 5 për qind e masës së plotë të saj. Për familjet bujqësore ndihma ekonomike mujore e pjesshme llogaritet si diferencë ndërmjet nivelit të përcaktuar në pikën 4 të këtij vendimi dhe të ardhurave aktuale të familjes, ku përfshihen edhe të ardhurat nga veprimtaria bujqësore.

4. Niveli i ndihmës ekonomike mujore të pjesshme është jo më i vogël se 50 për qind dhe jo më i madh se 100 për qind e të ardhurave të familjes me 1 ose 2 persona që përfitojnë pagesë papunësie sipas përcaktimit të pikës 1 dhe llogaritet në varësi nga numri i anëtarëve të familjes si vijon:

Familja me	1 anëtar	50 për qind e të ardhurave të familjes me 1 person që përfiton pagesë papunësie
" "	2 anëtarë	50 për qind e të ardhurave të familjes me 2 persona që përfitojnë pagesë papunësie
" "	3 "	deri 52 " " "
" "	4 "	" 53 " " "
" "	5 "	" 60 " " "
" "	6 "	" 62 " " "
" "	7 "	" 64 " " "
" "	8 "	" 66 " " "
" "	9 "	" 66 " " "

"	"	10	"	"	66	"	"	"	"
"	"	11	"	"	68	"	"	"	"
"	"	12	"	"	70	"	"	"	"

Familje me	13	anëtarë	deri 72	për qind të të	ardhurave të
"	"	14	"	74	familjes me 2 persona që përfitojnë pagesë papunësie
"	"	15	"	76	" " "
" mbi	15	"	100	"	" "

5. Për përfitimin e ndihmës ekonomike mujore të plotë ose të pjesshme nuk merret parasysh ndarja e familjes, me përjashtim të rasteve kur brenda saj krijohet kurorë e re.

6. Pagesa e ndihmës ekonomike bëhet në bashki dhe komuna nga personeli llogaritar arkëtar i tyre.

7. Ministria e Punës, Emigracionit dhe Përkrahjes Sociale dhe Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit ngarkohen të nxjerrin udhëzimet e nevojshme në zbatim të këtij vendimi.

8. Vendimet e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 30.6.1993 "Për dhënien e ndihmës ekonomike", nr.496, datë 18.10.1993 "Për një shtesë në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 30.6.1993", nr.528, datë 1.11.1993 "Për disa ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.328, datë 30.6.1993", shfuqizohen. Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.310, datë 24.7.1992, në kreun I, pika 1, shkronja "ç" shfuqizohet, kurse në kreun I, në pikën 2, shkronja "a" ndryshohet si vijon:

"Në masën deri 200 lekë në muaj për frymë:

a) personave që janë efektivisht në ngarkim të të punësuarve në sektorin shtetëror e privat; personave që marrin përkrahje sociale nga zbatimi i reformës ekonomike; personave që marrin pension; personave që marrin ndihmë ekonomike kur janë të vetëm ose kryefamiljarë; studentëve dhe nxënësve që përfitojnë bursë, kur janë kryefamiljarë".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrinë efektet financiare nga data 1 janar 1994.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi